

URDHËR
Nr. 170, datë 20.7.2018

PËR DELEGIM TË PËRKOUSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe të nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”; të nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Vettingut dhe Sigurimit Industrial, z. Mark Ndreca.
2. Ndër të tjera, z. Ndreca ngarkohet edhe me:
 - Ndjekjen e detyrave të vendosura në planin mujor të muajit korrik–gusht 2018;
 - Ndjekjen dhe zbatimin e “Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (të ndryshuar).
3. Delegimin e kompetencave të titullarit në funksion të Kontrollit të Figurës së subjekteve të rivlerësimit, përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, anëtare e grupit të punës, znj. Marsida Fetishi.
4. Znj. Marsida Fetishi i delegohen kompetencat, si më poshtë:
 - a) Mbikëqyr dhe udhëzon grupin e punës për Kontrollin e Figurës së subjekteve të rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.
 - b) Përfaqëson grupin e punës në marrëdhëniet, me:
 - Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK);
 - Kolegjin e Apelimit (KA) dhe Komisionerët Publikë;
 - Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).
 - c) Organizon dhe drejton veprimtarinë e grupit të punës.
 - ç) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur grupi i punës.
5. Mbledhjet e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) do të mbledhen sipas nevojës së procesit të rivlerësimit kalimtar nga nënkryetari i KDZH-së.
6. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën 23.7.2018 deri 10.8.2018.
7. Z. Ndreca dhe znj. Fetishi nuk mund t’i delegojnë këto kompetenca.
8. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Vettingut dhe Sigurimit Industrial.
9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.
10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI
Dorian Tola